



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 661/6 Prot.

Tiranë, më 28.12.2023

V E N D I M

Nr. 260, Datë 28.12.2023

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 100, datë 29.05.2023¹, e F.K kundër Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug, (në vijim ASHK Tirana Jug) në të cilën pretendohet për diskriminim për “çdo shkak tjetër²”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe në informacionin e dërguar në datë 08.06.2023, subjekti ankues, në mes të tjerash informon se: “Unë i nënshkruari F.K, lindur në Klos, rrethi Mat dhe banues në Tiranë, që në vitin 1998 e në vazhdim sqaroj se: Në vitin 2000 kam blerë një objekt në ndërtim e sipër në zonën e Kodrës së Priftit, sot rruga e Kokonozëve, nr. 229. Pas kësaj periudhe në vitin 2004 kam përfunduar ndërtimin e plotë të objektit dhe që nga koha e lidhjes së marrëveshjes dypalëshe, jam posedues i plotë i kësaj prone pa asnjë shqetësim, konflikt apo pretendim nga të tretët duke paguar rregullisht taksat dhe aktmarrëveshjet me OSHEE dhe UKT, të faktuara nëpërmjet dokumentacionit.

Në vitin 2005 sipas ligjit të legalizimeve kam bërë vetëdeklarimin (nr. 843/05, datë 17.03.2005) e ndërtimit të objektit duke paguar sipas ligjit faturat e shërbimit. Pas kësaj periudhe është bërë kualifikimi dhe hartimi i plotë i dokumentacionit tekniko-ligjor nga ana e specialistëve të ALUIZNIT në atë kohë, sot ASHK. Po në këtë kohë është miratuar zona informale si dhe është bërë kalimi i parcelës ndërtimore me VKM nr. 1180, datë 05.08.2008,

¹ Ankesa është plotësuar me shkresën e protokolluar me tonën me nr. 661/1, datë 08.06.2023.

² Referuar Letërnjoftimit nr. 032451164, rezulton se F.K, ka lindur në: Bel, Burrel.

sipas ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 dhe është bërë publikimi nga ana e ALUIZNIT, në datë 29.03.2010, referuar Fletores Zyrtare nr. 136/2008.

Për më tej, me shkresën nr. 6400, datë 24.10.2010, pas miratimit dhe hartimit të plotë të dokumentacionit kam marrë njoftim mbi pagesën e faturës financiare për parcelën dhe taksën e ndikimit në infrastrukturë, të cilën sipas shumës së pasqyruar janë paguar në Bankën Credins, sipas mandat pagesës me datë 26.12.2011.

Pas këtij veprimi më është thënë që do t'ju njoftojmë me postë për përfundimin e procesit dhe pajisjen me certifikatë pronësie, gjë e cila nuk ka ndodhur pavarësisht përfundimit të procedurave dhe kërkesave të njëpasnjëshme nga ana ime, nuk kam patur asnjë përgjigje, ndërkohë në të njëjtën kohë, objekte në të njëjtën zonë kadastrale dhe informale kishin përfunduar procesin dhe ishin pajisur me dokument pronësie. Genplani shoqërues e vërteton këtë fakt, në të cilin figurojnë dhe objektet të cilat kanë fituar status pronësimi, në të njëjtën gjurmë projekti, faktuar kjo dhe nga planimetria e projektit të unazës lindore "Rikualifikimi i unazës lindore për lotet 4, 5, 6", lëshuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Pas një periudhe 10 vjeçare ASHK Tirana Jug më njofton (shkresa nr. 612, datë 28.01.2022) se objekti në emrin tim me nr. prone 3/762, në zonën kadastrale 8170, përjashtohet nga legalizimi (Vendimi nr. 1811, datë 27.01.2022) sepse nuk plotëson kriteret, prandaj nuk kualifikohet (proces i cili kishte përfunduar që në vitin 2010).

Vendimi i marrë nga institucioni nuk ka përcaktuar se cilat janë kriteret të cilat nuk janë plotësuar. Si rrjedhojë e këtij veprimi, ka sjellë humbjen e së drejtës për shpronësim të barabartë dhe të njëjtë me persona dhe objektet të të njëjtës zonë informale dhe kadastrale, të cilët preken nga ndërtimi i segmentit rrugor "Unaza e Madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja-Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë". Për sa më sipër unë mendoj se shkak i këtij trajtimi diskriminues vjen nga prejardhja ime, interesi korruptiv dhe kundërshtimi nga ana ime për dhënie ryshfeti".

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin e të drejtës së mohuar.

I. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Hapat proceduralë të ndjekur nga strukturat përkatëse të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, paraqiten si më poshtë vijojnë:

Pas analizimit paraprak të ankesës, u konstatua se nga pikëpamja formale, ajo i plotësonte kërkesat e parashikuara nga neni 33/3 të ligjit 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", të ndryshuar. Në këto kushte Komisioneri, filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 661/2, datë 27.06.2023, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar parashtrime nga subjektet, lidhur me pretendimet e subjektit ankues, si dhe ka kërkuar dokumentacionin si më poshtë:

- Kopje të plotë të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga ana juaj, lidhur me rastin e legalizimit të banesës së F.K.
- Informacion lidhur me statusin juridik (të legalizuara, të pa legalizuara) të objekteve të banimit që janë në afërsi të banesës (ose kufitarë) së F.K dhe që kanë përfunduar procesin e legalizimit. Kopje të praktikave të banesave të legalizuara dhe të palegalizuara dhe kopje të letërnjoftimit të pronarit të këtyre objekteve.

Me shkresën nr. 5006/1, datë 05.07.2023, ASHK Tirana Jug, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Me formularin e datës 17.03.2005 rezultoi se F.K të ketë vetëdeklaruar objektin shtëpi banimi me dy kate për përfshirje në procedura të legalizimit të ndërtimit informal. Pas verifikimit të gjendjes faktike të objektit, u mbajt Akt-Evidentimi në terren nr. 859, datë 27.01.2022. Gjatë hartimit të materialit tekniko-ligjor dhe shqyrtimit të gjithë dokumentacionit në emër të F.K, vetëdeklaruar me nr. 843/05, datë 17.03.2005, rezultoi se preket nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i ri Tiranë-Shkozë”.*

Në zbatim të nenit 18, të Ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare” si dhe pikës 15/gj, 15/h të VKM-së nr. 1040/2020 “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kriterëve të legalizimit dhe miratimit të modelit të aktit të legalizimit për ndërtimet pa leje”, ky ndërtim informal nuk i plotëson kriteret kualifikuese dhe për pasojë i është nënshtruar përjashtimit nga procesi i legalizimit ku u vijua me Vendimin nr. 1811, datë 27.01.2022 “Për moslegalizimin e ndërtimit informal”. Me shkresën nr. 612, datë 28.01.2022, është njoftuar F.K mbi vendimin e përjashtimit.

Sqarojmë se vlerësimi për mos legalizimin e ndërtimit pa leje është bërë në kuadër të shkresës nr. 11175, datë 09.12.2021, të Autoritetit Rrugor Shqiptar (ARRSH), përcjellë me kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së nr. 21826/1, datë 22.12.2021 si dhe në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3 dhe nr. 4, datë 13.07.2021 dhe Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”, i ndryshuar, për vijimin e procedurave të shpronësimeve për pasuritë të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”.

Për sa i përket kërkesës tuaj për dokumentacion në lidhje me objektet kufitar të banesës së F.K të cilët janë të legalizuar ose jo, ju bëjmë me dije se, bazuar në Urdhrin nr. 470, datë 06.05.2019 “Për përcaktimin e kompetencës së disa drejtorive të ASHK”, Drejtoria Vendore Tirana Jug administron dosjet me leje legalizimi të A.L të kufitarit të subjektit ankues. Në lidhje me subjektet e tjerë kufitarë, Drejtoria jonë nuk ka informacion, pasi i përket zonës kadastrale e cila është kompetencë e Drejtorisë Vendore e ASHK-së Rurale 1”.

Në vijim, ankuesi me e-mail-in datë 07.08.2023, kërkoi kopje të dokumentacionit të dërguar nga ASHK Tirana Jug me shkresën nr. 5006/1, datë 05.07.2023.

- Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 661/4, datë 15.08.2023 njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 30.08.2023, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca u zhvillua në datë 30.08.2023, vetëm me praninë e subjektit ankues, pasi ASHK Tirana Jug megjithëse kishte marrë njoftim (RR 457 127 185 AA, datë 16.08.2023) nuk u paraqit në seancën dëgjimore.

Gjatë seancës dëgjimore, ankuesi i qëndroi të njëjtave parashtrime që kishte bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me KMD-në.

II. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshëm.

Gjatë shqyrtimit të ankesës dhe ndjekjes së procedurës hetimore, Komisioneri në përputhje me parashikimet ligjore ka kërkuar informacionin e nevojshëm dhe dokumentacionin mbështetës, lidhur me rastin e ankuesit, në mënyrë që të mund të vlerësonte me objektivitet pretendimin e tij për trajtim të padrejtë dhe diskriminues.

Komisioneri ka përmbushur kërkesat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, edhe sa i takon dhënies së ndihmës efektive, gjë e cila është përcaktuar në nenin 10, të tij: *“Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur. Ai i informon palët mbi të drejtat dhe detyrimet e tyre, përfshirë të gjithë informacionin e lidhur me procedurën dhe i paralajmëron ato për pasojat ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të tyre”.*

LMD në nenin 32, pikën 2, të tij ka përcaktuar qartë këtë detyrim, duke cituar se: *“Të gjitha institucionet publike dhe subjektet private janë të detyruara të mbështesin Komisionerin, duke i dhënë informacionin që i nevojitet dhe duke i garantuar aksesin në informacion në përmbushjen e detyrave të tij”.*

Nga ana e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi janë marrë të gjitha masat që subjekti kundër të cilit është bërë ankesa të vihet në dijeni për ankesën e bërë dhe i janë ofruar mundësitë që të jepte shpjegime, informacion dhe dokumentacion provues mbi pretendimet e ngritura nga subjekti ankues.

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktima e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”.

Një nga format e diskriminimit parashikuar nga ligji, është diskriminimi i drejtpërdrejtë, i cili përkufizohet nga neni 3/2, i ligjit si një situatë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të mbrojtur në nenin 1 të këtij ligji.

Bazuar në dispozitat e mësipërme ligjore, të cilat japin përkufizimin e diskriminimit, për të arritur në përfundimin se ankuesi është diskriminuar duhet të plotësohen njëkohësisht 3 elementë:

- është trajtuar në mënyrë të padrejtë, të pabarabartë dhe të pafavorshme. Ky trajtim mund të realizohet me veprime ose mosveprime, duke refuzuar t'i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi;
- në krahasim me sesi janë trajtuar ose do të trajtoheshin të tjerët në një situatë të ngjashme;
- dhe arsyeja për këtë trajtim të padrejtë është një nga shkaqet që gëzojnë mbrojtje nga ligji.

Sa më sipër, për të vlerësuar pretendimin për diskriminim të parashtruar nga ankuesi, në radhë të parë Komisioneri do të vlerësojë nëse ai i është nënshtruar ndonjë trajtimi të padrejtë, të pabarabartë dhe më pak të favorshëm, në të drejtën e tij për të përfituar të mira apo shërbime nga ana e ASHK Tirana Jug dhe më konkretisht në lidhje me legalizimin e banesës së tij.

Bazuar në provat e administruara gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës dhe në analizë të sa më sipër, rezultoi se:

F.K nëpërmjet formularit të Vetëdeklarimit për legalizim, ka aplikuar për legalizimin e banesës së tij në datë 17.03.2005 (praktika e legalizimit nr. 843/05, datë 17.03.2005).

Me shkresën nr. 6400, datë 26.10.2010, të ALUIZNI-t, Drejtoria Rajonale për Qarkun Tiranë, është njoftuar për formularët e pagesave për: Pagesë tarifë shërbimi; Pagesë taksë ndikimi në infrastrukturë për objekt të parë; Pagesë e vlerës së parcelës me bono privatizimi; Pagesë e vlerës së parcelës ndërtime, të cilat janë paguar sipas shumave të llogaritura, nga ana e F.K në Bankën Credins, sipas mandat pagesave me datë 26.11.2010 dhe 26.12.2011.

Në datë 30.08.2014 nga ana e punonjësve të Drejtorisë së ALUIZNI-Tiranë 1, Qarku Tiranë është mbajtur Proces-Verbal Konstatimi, për objektin e deklaruar nga F.K me vetëdeklarimin nr. 843/05, datë 17.08.2005.

Në datë 15.09.2014 nga ana e punonjësit të Sektorit të Përpunimit të të Dhënave të Drejtorisë së ALUIZNI-t Tiranë 1, është mbajtur Proces-Verbal i Vlerësimit të Dosjes së Legalizimit, për objektin e deklaruar nga F.K me vetëdeklarimin nr. 843/05, datë 17.08.2005.

Autoriteti Rrugor Shqiptar, me shkresën nr. 11175, datë 09.12.2021, i është drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së në të cilën e ka informuar se në zbatim të Vendimit të Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3 dhe nr. 4, datë 13.07.2021 dhe Ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 *“Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë së paluajtshme pronë private për interes publik”*, i ndryshuar, për vijimin e procedurave të shpronësimeve për pasuritë të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor *“Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”*.

Në datë 27.01.2022 nga ana specialistit të ASHK Tiranë Jug, është mbajtur Akt Evidentimi nr. 859, datë 27.01.2022, për gjendjen ndërtimore në terren, të ndërtimit pa leje, për objektin e deklaruar nga F.K.

ASHK Tirana Jug me Vendimin nr. 1811, datë 27.01.2022, ka vendosur moslegalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. 843/05, datë 17.03.2005, në zonën kadastrale nr. 8170, poseduar nga F.K.

ASHK Tirana Jug me shkresën nr. 612, datë 28.01.2022, ka njoftuar mbi vendimin e përjashtimit F.K duke informuar se: *“...Pas verifikimit të gjendjes faktike të objektit, hartimit të materialit tekniko-ligjor dhe shqyrtimit të gjithë dokumentacionit në emër të F.K, vetëdeklaruar me nr. 843/05, datë 17.03.2005, rezultoi se ndërtimi me të dhënat e sipërcituara, preket nga zbatimi i projektit “Unaza e Madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i ri Tiranë -Shkozë.....”*.

Ankuesi pretendon se edhe pse kanë kaluar 15 vjet, ai nuk ka fituar pronësinë mbi objektin e sipërpërmendur. F.K pretendon se zvarritja e procedurave për legalizimin e ndërtesës së tij të banimit është diskriminim, që atij i është bërë për shkak të prejardhjes (vendlindjes) dhe për shkak të korrupsionit.

Për sa më sipër, rezulton se vetëdeklarimi i ankuesit është depozituar pranë ish-ALUIZN-it, Drejtorisë Tiranë 1, i cili ka funksionuar deri në vitin 2018, periudhë në të cilën u miratua ligji nr. 111/2018 *“Për Kadastrën”*, nëpërmjet së cilit është krijuar Agjencia Shtetërore e Kadastrës, e cila ndër të tjera mori edhe funksionet e ish-ALUIZN-it. Ndërkohë që, nëpërmjet Urdhrit nr. 470, datë 06.05.2019, të Drejtorit të Përgjithshëm të Kadastrës, *“Për përcaktimin e kompetencës së disa Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës”* janë përcaktuar gjithashtu edhe kompetencat e Drejtorive të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të cilat do të shqyrtojnë në vijim kërkesat për legalizim të objekteve informale, të cilat ishin ende të papërfunduara nga Drejtoritë Rajonale të ALUIZN-it.

Në referencë të nenit 5, të Ligjit 20/2020 *“Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në Republikën e Shqipërisë”* Agjencia Shtetërore e Kadastrës është institucioni publik që organizohet dhe funksionon në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për kadastrën. ASHK është autoriteti publik përgjegjës për zbatimin e këtij ligji dhe për koordinimin e

proceseve në bashkëpunim me institucionet dhe organet e tjera qendrore shtetërore, njësitë e vetëqeverisjes vendore apo ndërmjet strukturave në përbërje të saj, me qëllim përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë.

Nga korrespondenca zyrtare e KMD-së me Drejtorinë Vendore Tirana Jug, të ASHK, rezulton se ARRSH e ka informuar Drejtorinë e Përgjithshme të ASHK-së nëpërmjet shkresës nr. 11175, datë 09.12.2021, për vijimin e procedurave të shpronësimeve për pasuritë të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, projekt i cili prekte territorin ku pozicionohet objekti informal i F.K.

Në pikën 5, të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” parashikohet shprehimisht: “5. Legalizimi i ndërtimeve pa leje nga drejtoritë vendore të ASHK-së bazohet në gjendjen faktike të tyre dhe në kriteret e përcaktuara në mënyrë shteruese në këtë vendim. Për efekt të procedurave kualifikuese, drejtoritë e ASHK-së bashkëpunojnë me institucione të tjera, duke iu përmbajtur parashikimeve të këtij vendimi. Institucionet janë të detyruara të shprehen mbi kërkesat e drejtorive vendore të ASHK-së brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga paraqitja e tyre. Në rast moskthimi të përgjigjes brenda këtij afati, ASHK-ja njofton organin epror të institucionit dhe/ose Kryeministrin.

Dokumentet e miratuara të planifikimit të territorit merren parasysh gjatë procedurës së kualifikimit vetëm për ato elemente, kushte apo kritere dhe vetëm në ato raste që janë të parashikuara shprehimisht në këtë vendim”.

Në pikën 15, germa gj) dhe h), të Vendimit nr. 1040, datë 25.11.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave të zbatimit të kritereve të legalizimit dhe miratimin e modelit të aktit të legalizimit, për ndërtimet pa leje” parashikohet shprehimisht: “Ndërtimi pa leje i llojit “objekt”, i ngritur brenda vijës kufizuese të zonës informale të miratuar ose zonës urbane, i përfshirë në fushën e zbatimit të ligjit nr. 20/2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë, nuk legalizohet nëse verifikohet një nga rastet e mëposhtme: gj) Preket nga zbatimi i një projekti konkret të infrastrukturës rrugore, ose të linjës energjetike të interkonjeksionit, të miratuar në mënyrë të posaçme nga Këshilli Kombëtar i Territorit; h) Autoriteti vendor ose institucioni shtetëror kompetent, për zbatimin e një projekti që përbën interes publik, në kuptim të legjislacionit për shpronësimet për interes publik, ka paraqitur kërkesë të argumentuar për përjashtim nga legalizimi, përpara se ASHK-ja të ketë miratuar legalizimin”.

Në këto kushte, për sa kohë që ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, në bazë të pikës 15, germa gj) dhe h), të VKM nr. 1040/2020, procesi i legalizimit nuk është vazhduar më tej nga ana e ASHK Tirana Jug.

Nga analizimi i fakteve të sipërcituara rezulton se legalizimi i objektit informal të deklaruar për legalizim nga ana e F.K nuk mund të kryhet, pasi ndërtesa informale, për të cilën ankuesi ka

depozituar vetëdeklarim për legalizim, preket nga ndërtimi i segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, të miratuar me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit nr. 3 dhe nr. 4, datë 13.07.2021.

Në këto kushte, lind natyrshëm pretendimi i ankuesit, se përse legalizimi i objektit informal të deklaruar nga ana e tij nuk është kryer para vitit 2021, pasi vetëdeklarimi i tij është depozituar në muajin mars 2005, pranë ish-Aluiznit, Drejtoria Rajonale Tiranë 1, pra rreth 16 vite më parë se të miratohej plani për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”.

Referuar parashikimit të nenit 6, pika 1 të ligjit nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, Agjencia Shtetërore e Kadastrës është person juridik publik në varësi të Kryeministrit, që krijohet me këtë ligj dhe funksionon si institucion me vetëfinancim.

Në nenin 67 të ligjit të sipërcituar parashikohet shprehimisht:

1. “Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet si bashkim i AITPP-së, ALUIZNI-t dhe ZRPP-së.
2. Agjencia Shtetërore e Kadastrës krijohet jo më vonë se 1 muaj nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Pas krijimit të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e Agjencisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritit të Zonave/Ndërtimeve Informale dhe Agjencisë së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike i ngarkohen ASHK-së”.

Për sa më sipër, Komisioneri gjykon se pavarësisht faktit se në vitin 2018, është kryer një riorganizim institucional, duke krijuar institucionin e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës dhe drejtorive të saj rajonale, detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve të suprimuara janë trashëguar tek institucionet e reja. Janë pikërisht Drejtoritë Rajonale të ASHK-së që shqyrtojnë dosjet e deklarimeve të pashqyrtuara nga ana e Ish-ALUIZN-it.

Ligji nr. 20, datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë³”, ka parashikuar si objekt të tij, përcaktimin e procedurave dhe organin shtetëror përgjegjës për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore, të regjistrimit të titujve të pronësisë për pasuritë e paluajtshme në pronësi shtetërore dhe private në Republikën e Shqipërisë, si dhe të inventarizimit, transferimit, trajtimit dhe regjistrimit përfundimtar të tyre.

Në nenin 2, pika 1/c), ka përcaktuar se, qëllimi i këtij ligji është: “1. Krijimi i bazës ligjore të thjeshtuar e të harmonizuar për përfundimin e proceseve kalimtare administrativo-ligjore të trajtimit të pronës së paluajtshme të shtetit dhe pronës private, duke përcaktuar normat për: c) legalizimin dhe regjistrimin në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, ndërtimeve pa leje, objekteve dhe trojeve funksionale, kur mungojnë aktet e fitimit të pronësisë, si dhe të oborreve në përdorim”.

Në Ligjin nr. 9482/2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar, në Ligjin nr. 20/2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në

³ Ligj i cili ka shfuqizuar Ligjin nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar.

Republikën e Shqipërisë” dhe në VKM nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kritereve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtimet me leje”, i ndryshuar, nuk ka të përcaktuar një afat kohor të saktë për përfundimin e procedurës administrative të nisur me vetëdeklarimin e kryer prej secilit individ për legalizimin e ndërtimit, kështu që për të përcaktuar afatet i referohemi nenit 91/2/3 të Kodit të Procedurave Administrative, në të cilin përcaktohet se: “2. Në mungesë të afateve të përcaktuara nga ligji i posaçëm, afati për përfundimin e procedurës administrative është 60 ditë. 3. Nëse ligji parashikon detyrimin e palës për të paraqitur dokumente ose prova, si pjesë ose së bashku me kërkesën për fillimin e procedurës, afatet e përcaktuara sipas pikave 1 ose 2, të këtij neni, fillojnë nga paraqitja e plotë e tyre”.

Nga analizimi i dokumenteve të shqyrtuara dhe legjislacionit të sipërcituar, konstatohet se pas datës 30.08.2014 dhe 15.09.2014 (kur është mbajtur Proces-Verbal Konstatimi dhe Proces-Verbal i Vlerësimit të Dosjes së Legalizimit) deri në datë 27.01.2022 kur është marrë Vendimi nr. 1811, për moslegalizimin e objektit të F.K, Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t Tirana 1 dhe më pas Drejtoria Vendore Tirana Jug, nuk kanë kryer asnjë veprim administrativ për legalizimin e objektit të F.K.

Mosrespektimi i kufirit kohor prej dy muajsh për përfundimin e procedurës administrative në rastin objekt shqyrtimi, është i dukshëm, dhe nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Jug nuk është dhënë asnjë justifikim i arsyeshëm për mosrespektimin e këtij afati procedural për përfundimin e procedurës administrative edhe nëse do të ekzistonte ndonjë situatë e veçantë, e parashikuar nga neni 91/4 të Kodit të Procedurave Administrative.

Procedura e legalizimit të objektit të F.K, nuk është përfunduar nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Jug, pa asnjë shkak të justifikuar ligjërisht edhe pse ankuesi kishte kryer pagesat e tarifave që në vitin 2010-2011. Kjo zvarritje shumëvjeçare i ka kushtuar ankuesit në heqjen e mundësisë të legalizimit të këtij objekti, pasi në vitin 2021, me miratimin e planit për ndërtimin e segmentit rrugor “Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë”, ndërtesa e tij informale preket nga rrjeti rrugor i parashikuar në këtë Plan.

Përsa më lart dhe lidhur me procedurën e ndjekur nga ana e Drejtorisë Vendore Tirana Jug, në raste të ngjashme me atë të ankuesit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i kërkoi këtij të fundit: “- *Informacion lidhur me statusin juridik (të legalizuara, të pa legalizuara) të objekteve të banimit që janë në afërsi të banesës (ose kufitarë) së F.K dhe që kanë përfunduar procesin e legalizimit*”.

Në përgjigje të kërkesës së Komisionerit, ASHK Tirana Jug vuri në dispozicion praktikën e legalizimit të A.L, i cili në jug është kufitar me pronën e F.K.

Në analizë të dokumentacionit të shqyrtuar rezulton se:

A.L nëpërmjet formularit të Vetëdeklarimit për legalizim, ka aplikuar për legalizimin e banesës së tij në datë 14.11.2006 (praktika e legalizimit nr. 842, datë 14.11.2006).

Në datë 09.03.2021 nga ana e punonjësve të ASHK Tirana Jug, është mbajtur Akt Evidentimi nr. 10, datë 09.03.2021, për gjendjen ndërtimore në terren, të ndërtimit pa leje, për objektin e deklaruar nga A.L.

ASHK Tirana Jug me Vendimin nr. 291, datë 19.03.2021, ka vendosur për legalizimin e ndërtimit pa leje, përfshirë në procedurat e legalizimit nëpërmjet aplikimit nr. 842, datë 14.11.2006, në zonën kadastrale nr. 8170, poseduar nga A.L.

Në një analizë krahasuese të procedurave të legalizimit mes F.K dhe A.L, të ndjekura nga ASHK Tirana Jug, rezulton se A.L ka kryer procesin e vetëdeklarimit në datë 14.11.2006, ASHK Tirana Jug ka bërë Akt Evidentimin në datë 09.03.2021 dhe Vendimin për legalizimin në datë 19.03.2021, ndërkohë F.K ka kryer procesin e vetëdeklarimit në datë 17.03.2005, ASHK Tirana Jug ka bërë Akt Evidentimin në datë 27.01.2022 dhe Vendimin për moslegalizimin në datë 27.01.2022.

Pra, nga analizimi i procedurave të sipërcituara, rezulton se A.L ka kryer procesin e vetëdeklarimit rreth 1 vit e gjysëm pas F.K, ndërkohë që ASHK Tirana Jug ka kryer procedurat e legalizimit për objektin e A.L rreth 10 muaj përpara procedurave të ndërmarra për objektin e F.K. Në këtë mënyrë evidentohet dhe trajtimi i pabarabartë i dy subjekteve që kishin ndërtime të paligjshme të cilët ishin në kushte të barabarta, pasi pronat e tyre janë kufitarë në të njëjtën zonë ku do zhvillohet projekti, ndërtimi i segmentit rrugor “*Unaza e madhe Tiranë, Sheshi Shqiponja, Bulevardi i Ri Tiranë-Shkozë*”.

Në analizë të gjithë sa më sipër, rezulton se vonesa në shqyrtimin e dokumentacionit dhe mbylljen e procedurave të legalizimit për objektin e F.K është bërë pa një shkak ligjor të justifikuar. Në referencë të parashikimeve ligjore që parashikojnë afatet e procedurave administrative të legalizimit, është më se e qartë se ligji ngarkon institucionin e ASHK Tirana Jug me barrën e provës për të vërtetuar mosrespektimin e këtij afati. Gjatë shqyrtimit të ankesës, ASHK Tirana Jug nuk arriti të provojë arsyet e vonesës në shqyrtimin e dokumenteve të legalizimit të objektit të F.K.

Për sa më sipër, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, Komisioneri vlerëson se, subjekti ankues, është ekspozuar haptazi para një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë nga ana e ASHK Tirana Jug.

B. Shkaku i mbrojtur.

Mbështetur në nenin 2⁴, të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, në ushtrimin e detyrës së tij siguron mbrojtjen efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin për një nga shkaqet që parashikon ky ligj. Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi ndalon situatat kur persona ose grupe

⁴“Qëllimi i këtij ligji është të sigurojë të drejtën e çdo personi për: a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b)barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga cdo forme sjelljeje qe nxit diskriminim.”

personash në një situatë të njëjtë trajtohen në mënyra të ndryshme, dhe situatat kur personat ose grupet e personave në situata të ndryshme trajtohen njësoj.

Në nenin 1 të tij përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

B.1 “Çdo shkak tjetër”.

Gjatë parashtrimeve të tij, subjekti ankues ka pretenduar diskriminim për “çdo shkak tjetër”, duke arsyetuar për shkak të vendlindjes, si i ardhur në Tiranë.

Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i ndryshuar, ofron mbrojtje dhe rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me një listë të hapur shkaqesh⁵. Në nenin 1, ligji liston një sërë shkaqesh për të cilat garantohet mbrojtja nga diskriminimi, por mbyllet me përcaktimin se ligji merr në mbrojtje edhe shkaqe të tjera që nuk janë listuar në nenin 1.

Neni 1, i ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar është në linjë edhe me parashikimet e nenit 14 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (KEDNJ-së), e cila sanksionon mbrojtjen nga diskriminimi bazuar në një listë të hapur shkaqesh⁶.

Krahas praktikës kombëtare, Komisioneri i referohet praktikës gjyqësore të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ). Ky referim bëhet duke mbajtur parasysh, hierarkinë e normave juridike të sanksionuar në nenin 116 të Kushtetutës, i cili sanksionon epërsinë e të drejtës ndërkombëtare të ratifikuar nga Republika e Shqipërisë mbi ligjet e brendshme. Në referim edhe të evokimit që i bëhet Konventës në nenin 17/2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ajo merr një status kushtetues në të drejtën tonë të brendshme. Për rrjedhojë edhe praktika e Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, me anë të të cilës bëhet interpretimi i Konventës, ka fuqinë e Konventës.

Referuar kësaj praktike, GJEDNJ-ja ka mbajtur qëndrimin se diferencat që kanë si bazë ose për arsye një karakteristikë personale, që e bën të dallueshme një person ose grup personash nga të tjerët, janë të lidhura me nenin 14 të Konventës dhe me këtë interpretim ajo ka përcaktuar statuse të tjera që nuk janë përcaktuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga neni 14 i Konventës. I njëjti

⁵ Neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje meose me çdo shkak tjetër.”*

⁶ Neni 14, I KEDNJ-së: *“Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.”*

arsyetim mund të na shërbejë edhe në rastin e vlerësimit të shprehjes me “*çdo shkak tjetër*”, të parashikuar në nenin 1 të ligjit 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar.

GJEDNJ-ja ka zhvilluar disa shkaqe në kategorinë “*statuse të tjera*”. Sipas praktikës së GJEDNJ-së, neni 14, i KEDNJ-së nuk ndalon të gjitha dallimet në trajtim, por vetëm ato diferenca të bazuara në një karakteristikë personale të identifikueshme, personale, ose “*status*”, me të cilin personat ose grupet e personave janë të dallueshëm nga njëri-tjetri⁷. Gjykata ka theksuar se fjalës “*shkak/status tjetër*” në përgjithësi i është dhënë një kuptim i gjerë⁸. Interpretimi i këtij nocioni “*nuk është kufizuar në karakteristika që janë personale në kuptimin që ato janë të lindura apo të pandashme*”⁹.

Disa karakteristika që GJEDNJ-ja ka njohur se mbrohen në kuadër të “*statuseve të tjera*” janë: Në *Engel dhe të tjerët kundër Vendeve të Ulta*, Gjykata vendosi që një dallim i bazuar në *gradën ushtarake* mund të binte në kundërshtim me nenin 14; Në *Larkos kundër Qipros*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i një *dallimi midis qiramarrësve të shtetit nga njëra anë dhe qiramarrësve të pronarëve privatë nga ana tjetër*; Në *Shelley kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata konsideroi se të qenit i *burgosur* mund të binte në nocionin e “*statusit tjetër*” sipas nenit 14; Në *Sidabras dhe Džiautas kundër Lituanisë*, Gjykata nuk adresoi në mënyrë specifike çështjen e “*statusit tjetër*”, por në gjetjen e një shkelje të nenit 14 dhe nenit 8 pranoi se *statusi si ish oficer i KGB-së*, përfshihet në nenin 14; Në *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata gjeti shkelje të nenit 14 si rezultat i dallimit që bëhej nga skema e lirimimit të parakohshëm bazuar në *kohëzgjatjen e dënimit me burg*.

Në çështjen Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar (paragrafi 60) GJEDNJ-ja është shprehur se: “*Pyetja nëse ekziston një ndryshim në trajtim bazuar në një karakteristikë personale ose të identifikueshme, në çdo rast është një çështje që duhet vlerësuar duke marrë parasysh të gjitha rrethanat e çështjes dhe duke pasur parasysh se qëllimi i Konventës është të garantojë jo të drejta që janë teorike ose jo reale, por të drejta që janë praktike dhe efektive*”.

Në këtë kontekst, bazuar në deklaratimet, faktet e provat e sjella nga palët, Komisioneri i vlerëson si shkak të mbrojtur nga LMD, referuar si “*çdo shkak tjetër*”¹⁰.

Një nga përkufizimet e cituara të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDN), është “*veçoria personale*” në bazë të së cilës, personat ose grupet e personave dallohen mes njëri-tjetrit. Sipas GJEDNJ, shkak i diskriminimit është individual, karakteristik për një individ, dhe nuk duhet konsideruar si relevant në kuptimin e trajtimit të ndryshëm ose gjatë gëzimit të disa përfitimeve të caktuara¹¹.

7 Shih: *Clift kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 55; *Kjeldsen Busk Madsen dhe Pedersen kundër Danimarkës*, prg 56; *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 61 dhe 70; *Novruk dhe të tjerët kundër Rusisë*, prg. 90.

8 Shiko: *Carson dhe të tjerë kundër Mbretërisë së Bashkuar*, prg 70.

9 Shiko: *Biao kundër Danimarkës*, aplikimi nr. 38590/10, prg.89.

10 Për analogji citojmë: Vendimin me nr. 176, datë 02.12.2019, Vendimin nr. 151, datë 28.10.2020 dhe Vendimin nr. 151, datë 11.08.2021, të KMD-së.

11 Handbook on European Non-discrimination Law’. EU FRA and CoE, 2010.97

Komisioneri vlerëson se, shkak i diskriminimit “vendlindja” i pretenduar nga ankuesi, pranohet si shkak i mbrojtur, bazuar në provat e depozituara në dosje. Referuar Çertifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile të Njësisë nr. 3 të Bashkisë Tiranë, të lëshuar në datë 16.03.2005, rezulton se F.K ka lindur në Bel, Burrel.

B.2 “Çdo shkak tjetër”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit se shkak për diskriminimin e tij është bërë interesi korruptiv dhe kundërshtimi nga ana e tij për të dhënë ryshfet, Komisioneri vlerëson se, hetimi i tyre nuk bën pjesë në kompetencën e KMD-së.

Pra, për sa më sipër është organi i Prokurorisë, organi kompetent që ushtron ndjekjen penale.¹²

Neni 1, dhe 1/b, i Kodit Penal, përcakton se: *“Ligji penal përcakton veprat penale, dënimet dhe masat e tjera që merren ndaj autorëve të tyre. Veprat penale ndahen në krime dhe në kundravajtje penale. Legjislacioni penal i Republikës së Shqipërisë ka për detyrë të mbrojë pavarësinë e shtetit dhe tërësinë e territorit të tij, dinjitetin e njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, rendin kushtetues, pronën, mjedisin, bashkëjetesën dhe mirëkuptimin e shqiptarëve me pakicat kombëtare, si dhe bashkëjetesën fetare nga veprat penale, si dhe parandalimin e tyre”.*

Neni 248¹³, i po këtij Kodi, përcakton se: *“Kryerja ose moskryerja me dashje e veprimeve a e mosveprimeve në kundërshtim me ligjin, që përbën mospërmbushje të rregullt të detyrës, nga personi që ushtron funksione publike, kur i kanë sjellë atij ose personave të tjerë përfitime materiale ose jomateriale të padrejta a kanë dëmtonuar interesat e ligjshëm të shtetit, të shtetasve dhe të personave të tjerë juridikë, nëse nuk përbën vepër tjetër penale, dënohet me burgim deri në shtatë vjet.”*

Kodi i Procedurës Penale, në nenet 277 e 278 të tij, ka parashikuar organet kompetente që ushtrojnë ndjekjen penale dhe që shprehen e disponojnë lidhur me të, shprehimisht: *“Prokurori dhe policia gjyqësore zhvillojnë, brenda kompetencave të caktuara, hetimet e nevojshme që lidhen me ushtrimin e ndjekjes penale. Prokurori drejton hetimet dhe ka në dispozicion policinë gjyqësore. Gjatë hetimeve paraprake, për rastet e parashikuara nga ligji, mbi kërkesën e prokurorit, të pandehurit, viktimës dhe palëve private, vendos gjykata.”*

C. Lidhja e trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë me shkakun e mbrojtur.

Mbështetur në provat e depozituara gjatë shqyrtimit administrativ të ankesës, rezultoi se subjekti ankues, i është nënshtruar një trajtimi të padrejtë dhe të pabarabartë dhe se ASHK Tirana Jug nuk dha asnjë shkak të arsyeshëm dhe objektiv për mos shqyrtimin në kohë të dokumenteve të legalizimit të objektit të ankuesit.

¹² Neni 148, i Kushtetutës së Shqipërisë shpreh se: *“Prokuroria ushtron ndjekjen penale....”*

¹³ Shpërdorim i detyrës.

Gjatë hetimit administrativ të kryer, lidhur me shqyrtimin e ankesës së shtetasit F.K, Komisioneri identifikoi se mosveprimi i institucionit të ASHK Tirana Jug ka vendosur ankuesin në kushte të pafavorshme dhe të pa justifikuar objektivisht nga një synim i ligjshëm.

Në kontekst të mbrojtjes ligjore që i garantohet individit lidhur me këtë shkak, Komisioneri është mbështetur në analizimin e legjislacionit kombëtar dhe atij ndërkombëtar, lidhur me këtë fakt.

Dinjiteti i njeriut është një vlerë themelore kushtetuese¹⁴. Një shoqëri demokratike, që bazohet në dinjitetin e njeriut dhe parimin e barazisë së gëzimit të të drejtave themelore nga të gjithë individët, duhet të garantojë plotësimin e nevojave bazike jetësore për të gjithë. Çdo individ është pjesë e një komuniteti shoqëror të caktuar dhe në këtë kontekst interpretohet edhe dinjiteti i njeriut, si një garanci themelore.

Sipas nenit 116, të Kushtetutës, marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditen menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ato zënë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhen të detyrueshme për t'u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.

Shqipëria ka nënshkruar e ratifikuar disa akte ndërkombëtare, që në thelb kanë të bëjnë me trajtimin e barabartë, mosdiskriminimin, mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut në përgjithësi, ndër të cilat është edhe Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila jo vetëm që është pjesë e e legjislacionit të brendshëm të Republikës së Shqipërisë, por zë një vend të veçantë brenda tij.

Neni 14, i KEDNJ, “*Ndalimi i diskriminimit*”, përcakton se: “*Gëzimi i të drejtave dhe i lirive të përcaktuara në këtë Konventë duhet të sigurohet, pa asnjë dallim të bazuar në shkaqe të tilla si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër*”¹⁵.

Gëzimi i të drejtave të shtetasve në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë. Neni 18 i Kushtetutës së RSH-së sanksionon se të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. Kreu i IV i Kushtetutës vë theksin tek liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, të cilat duhet të gëzohen de facto, në mënyrë të barabartë dhe pa diskriminim.

Lidhur me të drejtat themelore, shtetasit shqiptarë përballet me situata të vështira për sa i përket zbatimit të të drejtave lidhur me pronën, çështje kjo e ngritur dhe nga Komisioni Evropian në Raportin e Progresit 2020, në të cilin, në faqen 29 dhe 35 shkruhet se: “*Në vitin e ardhshëm, Shqipëria: - duhet të konsolidojë ngulitjen e të drejtave pronësore, veçanërisht përmes*

¹⁴Në Preambulën e Kushtetutës deklarohej: “*Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, identiteti kombëtar dhe trashëgimia kombëtare, bashkëjetesa fetare, si dhe bashkëjetesa dhe mirëkuptimi i shqiptarëve me pakicat janë baza e këtij shteti, i cili ka për detyrë t'i respektojë dhe t'i mbrojë*”.

¹⁵ Gjendja ekonomike përfshihet në opsionin “për çdo shkak tjetër”.

përfundimit të regjistrimit të parë, avancimit për regjistrimin e akteve të pronës, zbatimin e skemës së kompensimit dhe vazhdimin të progresit të duhur lidhur me digjitalizimin dhe hartëzimin e pronës. Fq. 35. Në lidhje me të drejtat e pronës, është i nevojshëm progresi i vazhdueshëm drejt përparimit të procesit të regjistrimit, digjitalizimit dhe kompensimit. Shqipëria, si çështje përparësie, duhet të përfundojë regjistrimin e parë të pronave të patundshme dhe të titujve të pronësisë në territorin e saj”.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një institucion barazie i specializuar për mbrojtjen nga diskriminimi, në zbatim të dispozitave të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i ndryshuar, ka si qëllim të sigurojë të drejtën e çdo personi për: “a) barazi përpara ligjit dhe mbrojtje të barabartë nga ligji; b) barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat, për të gëzuar liritë dhe për të marrë pjesë në jetën publike; c) mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe nga çdo formë sjelljeje që nxit diskriminimin”.

Ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë, si dhe përcakton shkaqet, në bazë të së cilave ndaj një individi mund të ketë diskriminim. Në nenin 1 të LMD, të ndryshuar, parashikohet mbrojtje nga diskriminimi, sipas një listë jo shteruese shkaqesh, ku përfshihet dhe “vendlindja”. Në referencë të nenit 3, pika 1, të LMD, të ndryshuar “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.

Nëpërmjet parashikimit të nenit 20, pika 1, të ligjit të sipërpërmendur ndalohet diskriminimi, në fushën e të mirave dhe shërbimeve, për shkaqet e parashikuara në nenin 1, të këtij ligji. Në këtë nen parashikohet shprehimisht: “Personi fizik ose juridik që ofron të mira apo shërbime për publikun, me pagesë ose jo, ndalohet të diskriminojë një person tjetër, i cili kërkon t’i arrijë ose t’i përdorë ato: a) duke refuzuar t’i japë një personi apo grupi personash të mira apo shërbime për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji; b) duke refuzuar t’i ofrojë një personi të mira apo shërbime në mënyrë të ngjashme, ose me cilësi të ngjashme, ose në kushte të ngjashme me ato në të cilat këto të mira apo shërbime i ofrohen publikut në përgjithësi”.

Për të vërtetuar faktin se ankuesi është ekspozuar ndaj një sjellje diskriminuese nga ana e ASHK Tirana Jug, duhet të ekzistojë një lidhje objektive shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar dhe trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë të ankuesit.

Bazuar në konkluzionet e pjesës A, të Vendimit, Komisioneri konkludoi se, subjekti ankues është trajtuar në mënyrë të padrejtë dhe të pabarabartë lidhur me mostrajtimin në kohë të vetëdeklarimit të tij, duke i kushtuar ankuesit në heqjen e mundësisë të legalizimit të objektit të tij.

Por, Komisioneri vlerëson se, pavarësisht konstatimit të këtij fakti, ankuesi nuk arriti të provojë se shkak i pretenduar prej tij (vendlindja) ka shërbyer si shkak për të cilin ai është diskriminuar nga ana e ASHK Tirana Jug.

- Në analizë të dokumentacionit të vënë në dispozicion nga palët, referuar Çertifikatës familjare të F.K rezulton se ai ka lindur në Burrel. Gjithashtu, referuar Çertifikatës familjare të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile e Bashkisë Tiranë, rezulton se A.L ka lindur në Mat.
- Pra, siç shikohet edhe A.L që i është legalizuar prona dhe që është kufitar me pronën e F.K, ka të njëjtën vendlindje.
- Në këtë kontekst, Komisioneri vlerëson se, vendlindja (prejardhja) e ankuesit, nuk mund të ketë shërbyer si shkak për trajtimin e padrejtë e të pabarabartë të tij nga ana e ASHK Tirana Jug.

Bazuar në faktet dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit të ankesës, pavarësisht konstatimit të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë ndaj ankuesit nga ana e ASHK Tirana Jug, lidhur me mostrajtimin në kohë të vetëdeklarimit të tij dhe ekzistencës së shkakut të mbrojtur të diskriminimit, faktet dhe provat e administruara janë të pamjaftueshme për të krijuar prezumimin se kjo sjellje të cilës i është nënshtruar ankuesi është për shkak të vendlindjes.

Komisioneri vlerëson se, në kushtet kur bazuar në faktet dhe provat e administruara nuk mund të prezumohet se diskriminimi ka ndodhur, ASHK Tirana Jug, nuk mund të ngarkohet me detyrimin për të provuar se trajtimi i padrejtë dhe i pabarabartë të cilit i është nënshtruar ankuesi, përbën diskriminim.

Konstatimi i trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë dhe ekzistenca e shkakut të pretenduar të diskriminimit, nuk mund të çojnë *apriori* në përfundimin se jemi përpara një sjellje diskriminuese, për sa kohë që nuk mund të prezumohet lidhja shkakësore, pra se shpjegimi i vetëm i arsyeshëm për moslegalizimin e banesës së F.K, është vendlindja e tij në raport me banorët e tjerë që ishin në proces legalizimi.

Sjellja diskriminuese në çdo rast është një sjellje e paligjshme, por jo çdo paligjshmëri përbën diskriminim, pasi për t'u konsideruar i tillë duhet të lidhet domosdoshmërisht me një shkak të mbrojtur të LMD-së.

Sa më sipër, Komisioneri arrin në përfundimin se ankesa e paraqitur nga subjekti ankues me pretendimin për diskriminim, për shkak të “vendlindjes”, është e pabazuar, pasi nuk rezultoi e provuar që ASHK, Drejtoria Vendore Tirana Jug të ketë shkelur dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 32 dhe 33, të ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të F.K, për shkak të vendlindjes, nga ana e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Drejtoria Vendore Tirana Jug.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

KOMISIONERI

Robert GAJDA